



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
- Kuvendi i Komunës-
01Nr. 350-9162/2012
Kaçanik, 30.04.2012

Në bazë të nenit 10 të Ligjit për menaxhimin e pronës së paluajtshme të komunës, të nenit 14.1 të Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 30.04.2012, mori këtë:

VENDIM
PËR NDËRRIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME

I.

1. Me këtë Vendim, bëhet ndërrimi i pasurisë së paluajtshme në mes të Kuvendit të Komunës Kaçanik dhe ate: parcela kadastrale nr. 150/1, me kulturë kullosë e kl.4, në sipërfaqe : 0.15.43 ha e shënuar sipas fletës poseduese nr.50, Zona Kad. Duraj-Gabrricë, e cila pasuri e paluajtshme kalon në emër të Tahire Memishi, e veja e Shabanit nga f. Elezaj.

2. Parcela kadastrale nr. 148/2, me sipërfaqe : 0.03.09 ha dhe parcela kadastrale nr. 149/1, me sipërfaqe: 0.13.88 ha , Fleta poseduese nr. 46, Zona Kadastrale Duraj-Gabrricë, kalojnë në emër të Pronës Komunale të Kuvendit të Komunës Kaçanik.

II.

Me këtë Vendim, obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, t'i ndërmerr veprimet e nevojshme për ndryshimet kadastrale në RDPP.

III.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

IV.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me këtë Vendim njoftohet:

1. Kryetari i komunës,
2. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe
3. Arkiva.

Kryesuesi i kuvendit,
z. Xhelal Gashi
